

ANKESË

DREJTUAR: **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), Prishtinë**

NGA: Grupi i Operatorëve Ekonomik **KSF MAJOR SH.A. & MEB L.L.C.**

KUNDËR: Autoritetit Kontraktues "Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë"
(Departamenti i Prokurimit)

NUMRI I AKTIVITETIT TË PROKURIMIT: **MINTI204-26-1851/005-2-1-1**

TITULLI I KONTRATËS: "Shërbimet e sigurimit fizik për objektet e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë"

Data: 26.07.2026



Ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues, datë 17.07.2026, me të cilin është refuzuar si e pabazuar Kërkesa për Rishqyrtim, si dhe kundër Vendimit për dhënie të kontratës (Formulari B58, datë 08.07.2026), në aktivitetin e prokurimit: "Shërbimet e sigurimit fizik për objektet e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë" Nr. i Prokurimit: MINTI204-26-1851/005-2-1-1

I.BAZA LIGJORE E ANKESËS

Në mbështetje të nenit **109** të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar (në tekstin e mëtejshëm: **LPP**), si dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores për Parashtrimin e Ankesave pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), brenda afatit ligjor paraqesim këtë ankesë kundër vendimeve të Autoritetit Kontraktues, të cilat janë nxjerrë në kundërshtim me dispozitat imperative të LPP-së, Dosjen e Tenderit, parimet themelore të prokurimit publik dhe praktikën e konsoliduar të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Grupi i Operatorëve Ekonomik **KSF MAJOR SH.A. & MEB L.L.C.** është operator ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit dhe, në kuptim të nenit **109 të LPP-së**, gëzon interes të drejtpërdrejtë juridik për paraqitjen e kësaj ankese, pasi me vendimet e kundërshtuara i janë cenuar drejtpërdrejt të drejtat dhe interesat legjitime për një vlerësim të drejtë, të paanshëm dhe në përputhje me ligjin. Oferta jonë është eliminuar pa bazë ligjore, në kundërshtim me faktet, provat dhe dokumentacionin e dorëzuar gjatë procedurës, ndërsa kontrata është rekomanduar një operatori ekonomik i cili nuk i plotëson kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit dhe, si i tillë, nuk ka mundur ligjërisht të shpallet operator ekonomik i përgjegjshëm. Për rrjedhojë, vendimet e Autoritetit Kontraktues cenojnë rëndë parimet e **ligjshmërisë, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, transparencës dhe konkurrencës së ndershme**, të garantuara me **nenin 7 të LPP-së**, si dhe bien ndesh me detyrimin ligjor të Autoritetit Kontraktues për të zhvilluar një procedurë objektive, të paanshme dhe të bazuar ekskluzivisht në kriteret dhe kërkesat e Dosjes së Tenderit.

II. OBJEKTI I ANKESËS

Me këtë ankesë kundërshtohen në tërësi:

1. Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës **17.07.2026**, me të cilin është refuzuar si e pabazuar Kërkesa për Rishqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik **KSF MAJOR SH.A. & MEB L.L.C.**;
2. Vendimi i Autoritetit Kontraktues (Formulari **B58**) i datës **08.07.2026**, me të cilin është rekomanduar për dhënie të kontratës Operatori Ekonomik **International Security AAH SH.P.K.**.

Ankuesi konsideron se të dy këto vendime janë nxjerrë në kundërshtim flagrant me dispozitat imperative të Ligjit për Prokurimin Publik, kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit dhe standardet juridike që rregullojnë procedurat e prokurimit publik. Vendimi për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim nuk përmban analizë individuale dhe juridike të pretendimeve të ngritura nga Ankuesi, nuk trajton provat e dorëzuara dhe nuk jep arsytim të plotë e të verifikueshëm për refuzimin e tyre, por kufizohet në konstatime të përgjithshme dhe përfundime të pambështetura në prova materiale. Si i tillë, **ai nuk përmbush standardin e një vendimi administrativ të arsyetuar dhe nuk korrigjon shkeljet e kryera gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.** Njëkohësisht, me vendimin për rekomandimin e kontratës është shpallur fitues një operator ekonomik i cili nuk përmbush kërkesa thelbësore të Dosjes së Tenderit, ndërsa oferta e Ankuesit është eliminuar **mbi baza hipotetike dhe jo mbi fakte të provuara, duke krijuar një standard të dyfishtë vlerësimi, në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.**

III. HISTORIKU I PROCEDURËS

Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar procedurën e prokurimit për ofrimin e shërbimeve të sigurimit fizik për objektet e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, duke përcaktuar në Dosjen e Tenderit kriteret administrative, profesionale, teknike dhe financiare që çdo operator ekonomik ishte i detyruar t'i plotësonte për t'u konsideruar ofertues i përgjegjshëm. Grupi i Operatorëve Ekonomik **KSF MAJOR SH.A. & MEB L.L.C.** ka dorëzuar ofertën e tij brenda afatit ligjor, duke plotësuar të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe duke bashkëngjitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar administrativ, profesional, teknik dhe financiar, në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Gjatë fazës së ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave, Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar Ankuesit sqarim vetëm lidhur me **përshkrimin e çmimit të ofertuar**, respektivisht nëse çmimi i paraqitur në ofertë ishte **me TVSH apo pa TVSH**, e jo sqarime lidhur me realizueshmërinë ekonomike të ofertës, strukturën e kostove apo elementet financiare të saj. Në **përputhje të plotë me kërkesën e Autoritetit Kontraktues dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara**, Ankuesi ka dorëzuar sqarimin e kërkuar. Për më tepër, ndonëse kjo nuk ishte kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, Ankuesi, duke vepruar në mirëbesim, në funksion të transparencës së plotë dhe për të eliminuar çdo paqartësi të mundshme, ka bashkëngjitur edhe Deklaratat për rrespektimin Ligjin e punës, Ligjin për paga 10/273 respektivisht 500 bruto përmes së cilës ka dëshmuar:

- a. strukturën reale dhe të detajuar të kostove;

b. metodologjinë e kalkulimit të ofertës, bazën ekonomike të çmimit dhe realizueshmërinë financiare të kontratës;

c. ka deklaruar në mënyrë të qartë, të pakushtëzuar dhe juridikisht detyruese se gjatë realizimit të kontratës do të respektohen në tërësi të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit, përfshirë pagën minimale prej **500.00 € bruto**, pagesën e kontributeve pensionale, detyrimet që burojnë nga Ligji i Punës dhe çdo detyrim tjetër ligjor.

Për më tepër, si pjesë përbërëse e ofertës sonë, në Dosjen e Tenderit janë dorëzuar **deklarata zyrtare, të nënshkruara dhe të vulosura** nga Grupi i Operatorëve Ekonomik **KSF MAJOR SH.A. & MEB L.L.C.**, përmes të cilave kemi marrë obligim të qartë juridik dhe kontraktual se gjatë realizimit të kontratës do të respektojmë në tërësi të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës, përfshirë **Ligjin sigurisë fizike, Ligjin e Punës, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/273** për pagën minimale prej **500.00 € bruto**, pagesën e rregullt të kontributeve pensionale, detyrimet tatimore, legjislacionin për sigurimet dhe çdo detyrim tjetër që buron nga legjislacioni në fuqi, si dhe të gjitha kërkesat dhe specifikimet e Dosjes së Tenderit. Këto deklarata përbëjnë pjesë integrale të ofertës sonë dhe krijojnë obligime juridike e kontraktuale të detyrueshme për Ankuesin gjatë ekzekutimit të kontratës. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur asnjë bazë ligjore që, duke shpërfillur dokumentacionin dhe deklaratimet zyrtare të dorëzuara nga Ankuesi, të ndërtojë vendimmarrjen e tij mbi supozime ose dyshime hipotetike se Ankuesi në të ardhmen nuk do t'i respektojë këto obligime.

Megjithatë, pa kërkuar asnjë sqarim shtesë lidhur me analizën financiare të dorëzuar, pa identifikuar asnjë mangësi konkrete në dokumentacionin tonë dhe pa zhvilluar procedurën e paraparë me **nenin 61 të LPP-së** në mënyrën e kërkuar nga ligji, Autoriteti Kontraktues vendosi eliminimin e ofertës sonë mbi baza hipotetike dhe jo mbi prova konkrete, duke vepruar në kundërshtim me **nenet 7, 59, 61 dhe 72 të LPP-së**.

Vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk identifikon **asnjë element konkret** të analizës sonë financiare apo të dokumentacionit të dorëzuar që do të dëshmonte se oferta është ekonomikisht e perealizueshme ose se nuk mbulon detyrimet kontraktuale. Përkundrazi, Autoriteti Kontraktues ka zëvendësuar provat, dokumentacionin dhe deklaratimet zyrtare të Ankuesit me vlerësimin e tij subjektiv mbi mënyrën e mundshme të realizimit të kontratës në të ardhmen, ndonëse **Ligji për Prokurimin Publik nuk i jep asnjë kompetencë Komisionit të Vlerësimit që të eliminojë një operator ekonomik mbi bazën e parashikimeve apo supozimeve për ekzekutimin e ardhshëm të kontratës**. Çdo çështje që lidhet me respektimin e pagës minimale, të drejtave të punëtorëve apo obligimeve të tjera kontraktuale trajtohet gjatë fazës së menaxhimit dhe ekzekutimit të kontratës, përmes mekanizmave të paraparë në **nenin 81 të LPP-së**, si dhe përmes garancisë së ekzekutimit dhe mjeteve të tjera kontraktuale, e jo përmes eliminimit të ofertës në fazën e vlerësimit, kur operatori ekonomik ka dorëzuar të gjitha deklaratat dhe dëshmitë e kërkuara nga Dosja e Tenderit.

Ky veprim i Autoritetit Kontraktues përbën tejkalim të kompetencave ligjore të Komisionit të Vlerësimit, cenon parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe transparencës të garantuara me **nenin 7 të LPP-së** dhe e bën vendimin e kontestuar të kundërligjshëm, arbitrar dhe të pambështetur në prova materiale.

Lidhur me praktikën e mëhershme të Autoritetit Kontraktues dhe respektimin e parimit të përdorimit efikas të fondeve publike

Përveç argumenteve të paraqitura në këtë ankesë, GOE Ankues konsideron se Paneli Shqyrtues duhet të marrë në konsideratë edhe një rrethanë faktike me rëndësi, e cila dëshmon se Autoriteti Kontraktues, në procedurën objekt shqyrtimi, ka devijuar nga praktika e tij e mëhershme dhe nga parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik. Vlen të theksohet se **anëtari i GOE Ankues, MEB L.L.C., është operatori ekonomik i fundit që ka realizuar kontratën për ofrimin e shërbimeve të sigurimit fizik për nevojat e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT)** Po ashtu, është me rëndësi të theksohet se në procedurën e mëparshme të prokurimit me titull **"Sigurimi fizik i objekteve për nevojat e MINT"**, Anetari MEB L.L.C ishte rekomanduar për dhënie të kontratës me një ofertë që ishte rreth **30,000.00 € më e lirë** se oferta e operatorit ekonomik të renditur në vendin e dytë. Edhe pse operatori ekonomik i renditur i dyti kishte paraqitur ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (**Lënda nr. 200/25**), Paneli Shqyrtues e kishte **aprovuar pjesërisht ankesën, por nuk kishte ndryshuar rezultatin e procedurës**, duke lënë në fuqi vendimin e Autoritetit Kontraktues për rekomandimin e anetarit MEB L.L.C për dhënie të kontratës. Ky fakt dëshmon se **vetë Autoriteti Kontraktues, në procedurat e mëparshme, ka respektuar parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik, duke i dhënë përparësi ofertës së përgjegjshme me çmimin më të ulët**, në përputhje me nenet **1, 7, 59 dhe 60 të LPP-së**, si dhe me qëllimin e ligjit për të siguruar përdorimin sa më efikas dhe ekonomik të fondeve publike. Në procedurën aktuale, megjithatë, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në mënyrë diametralisht të kundërt. Në vend që të zbatojë të njëjtin standard që ka zbatuar në procedurat e mëhershme, ai ka eliminuar GOE Ankues mbi bazën e **supozimeve hipotetike**, pa prova objektive sipas nenit 61 të LPP-së, duke mos respektuar parimin e konsistencës në vendimmarrje administrative. Ndryshimi i një praktike administrative është i lejueshëm vetëm kur **mbështetet në arsye objektive, të ligjshme dhe të arsyetuara**. Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues **nuk ka dhënë asnjë arsytim bindës** pse në procedurën e mëparshme e ka konsideruar vendimtare ofertën me çmimin më të ulët dhe të përgjegjshme, ndërsa në procedurën aktuale ka eliminuar ofertën më të ulët mbi baza hipotetike, duke rekomanduar për kontratë një operator ekonomik me çmim më të lartë. Një qasje e tillë cenon jo vetëm **parimin e trajtimit të barabartë**, por edhe **parimin e sigurisë juridike, të konsistencës së vendimmarrjes administrative dhe të mbrojtjes së besimit legjitim**, pasi operatorët ekonomikë kanë të drejtë të presin që Autoriteti Kontraktues të zbatojë të njëjtat standarde ligjore në procedura të njëjta, përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të qarta dhe të arsyetuara për një devijim nga praktika e mëparshme. Për më tepër, eliminimi i ofertës së përgjegjshme me çmimin më të ulët, pa bazë të mjaftueshme ligjore dhe faktike, është në kundërshtim me **nenin 1 të Ligjit për Prokurimin Publik**, i cili obligon autoritetet kontraktuese të sigurojnë përdorimin sa më efikas, ekonomik dhe racional të fondeve publike.

Interpretimi i Gabuar i Natyrës së Kontratës dhe i Strukturës së Çmimit nga Autoriteti Kontraktues

Një nga gabimet më serioze juridike dhe faktike të Autoritetit Kontraktues gjatë vlerësimit të ofertës së GOE Ankues konsiston në interpretimin e gabuar të vetë natyrës së kontratës dhe të strukturës së çmimit të ofertës. Autoriteti Kontraktues e ka ndërtuar të gjithë arsyetimin e tij mbi premisën se **vlera e ofertës sonë prej 272,700.00 € përfaqëson një shumë fikse dhe të pandryshueshme për realizimin e kontratës për 24 muaj**, duke nxjerrë më pas përfundime se kinse kjo shumë nuk mjafton për mbulimin e pagave dhe shpenzimeve të tjera. Ky arsyetim është juridikisht dhe faktikisht i gabuar.

Nga Dosja e Tenderit, Specifikimet Teknike dhe kushtet kontraktuale rezultojnë qartë se kjo procedurë **nuk është kontratë me çmim fiks** por kontratë me **çmime për njësi**, ku operatorët ekonomikë kanë ofertuar

çmimin për një orë shërbimi, ndërsa vlera totale e ofertës është vetëm një **vlerë orientuese e përlllogaritur** mbi bazën e numrit të orëve të parashikuara nga Autoriteti Kontraktues. Kjo do të thotë se **272,700.00 € nuk është fond fiks kontraktor**, nuk është shumë e garantuar dhe nuk është shumë mbi të cilën duhet të ndërtohet analiza e realizueshmërisë së kontratës.

Në të kundërtën, pagesat gjatë realizimit të kontratës kryhen sipas **shërbimeve të kryera realisht**, respektivisht sipas **numrit real të orëve të realizuara**, në përputhje me çmimin për njësi të ofertuar dhe me kushtet e kontratës e cila AK ka drejte të rris apo të zvogloj pikat e cila është cekne në FDT si dhe devijimi është lejuar +30%. Prandaj, **Autoriteti Kontraktues ka analizuar një element që nuk ekziston në kontratë**, duke e trajtuar gabimisht vlerën orientuese të ofertës si një shumë fikse, ndërkohë që objekti real i ofertimit dhe i pagesës është **çmimi për orë**. Ky gabim metodologjik e bën të pabazuar të gjithë analizën financiare të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues ka tejkaluar kompetencat e tij duke **ndryshuar natyrën juridike të kontratës**. Një kontratë e paraparë si kontratë me **çmime për njësi** është trajtuar sikur të ishte kontratë me **çmim fiks**, duke aplikuar një metodologji vlerësimi që nuk është paraparë as në Dosjen e Tenderit dhe as në Ligjin për Prokurimin Publik.

Ky interpretim i gabuar ka ndikuar drejtpërdrejt në përfundimin e nxjerrë për ofertën e GOE Ankues dhe e bën të gjithë analizën financiare të Autoritetit Kontraktues juridikisht të pavlefshme.

Për rrjedhojë, vendimi për eliminimin e GOE Ankues nuk është rezultat i një analize objektive të ofertës së paraqitur, por i një analize të ndërtuar mbi një premisë faktike dhe juridike të gabuar. Duke qenë se e gjithë analiza e Autoritetit Kontraktues mbështetet në trajtimin e gabuar të vlerës orientuese prej 272,700.00 € si çmim fiks për 24 muaj, edhe përfundimi se oferta e GOE Ankues është e përealizueshme mbetet pa bazë ligjore dhe pa bazë faktike. Për këtë arsye, ky konstatim nuk mund të qëndrojë dhe nuk mund të shërbejë si bazë për eliminimin e ofertës sipas Ligjit për Prokurimin Publik.

Raporti i Vlerësimit të Tenderëve nuk përmban bazë ligjore për eliminimin e GOE Ankues

Gjatë ushtrimit të së drejtës për qasje në dokumentacionin e procedurës së prokurimit, GOE Ankues ka pranuar edhe **Raportin e Vlerësimit të Tenderëve**, i cili ka shërbyer si bazë për rekomandimin e Autoritetit Kontraktues. Pas analizimit të këtij raporti, konstatohet se **në asnjë pjesë të tij nuk identifikohet dispozita konkrete e Ligjit për Prokurimin Publik apo e Dosjes së Tenderit mbi të cilën është mbështetur eliminimi i GOE Ankues.**

Raporti nuk specifikon:

- dispozitën konkrete të Ligjit për Prokurimin Publik që pretendohet se është shkelur nga GOE Ankues;
- dispozitën konkrete të Dosjes së Tenderit që pretendohet se nuk është përmbushur;
- bazën juridike që autorizon eliminimin e ofertës;

Në vend të një analize juridike të bazuar në dispozita konkrete ligjore, Raporti i Vlerësimit të Tenderëve përmban vetëm konstatime të përgjithshme dhe përfundime të pambështetura në norma ligjore, duke mos

shpjeguar se mbi cilën dispozitë imperative të Ligjit për Prokurimin Publik është mbështetur eliminimi i GOE Ankues. **Ligji për Prokurimin Publik nuk lejon eliminimin e një operatori ekonomik pa një bazë të qartë ligjore.** Çdo vendim që kufizon të drejtën e një operatori ekonomik për të konkurruar duhet të mbështetet në një dispozitë konkrete të ligjit ose të Dosjes së Tenderit, e cila është shkelur në mënyrë të provuar. Në mungesë të një baze të tillë, eliminimi bëhet arbitrar dhe në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë. Për më tepër, **nenet 59, 60 dhe 61 të Ligjit për Prokurimin Publik** obligojnë Komisionin e Vlerësimit që të bëjë një vlerësim objektiv të ofertës, të analizojë dokumentet dhe sqarimet e operatorit ekonomik dhe të arsyetojë qartë çdo konstatim që çon në eliminimin e ofertës. Në rastin konkret, kjo nuk ka ndodhur. Gjithashtu, **neni 108/A i LPP-së** kërkon që, gjatë procedurës së rishqyrtimit, Autoriteti Kontraktues të japë një arsyetim të plotë ligjor dhe faktik për secilin pretendim të ngritur. Mirëpo, as Raporti i Vlerësimit të Tenderëve dhe as vendimi për rishqyrtim nuk identifikojnë normën juridike që justifikon eliminimin e GOE Ankues. Po ashtu, Raporti i Vlerësimit nuk demonstroi se Komisioni ka kryer ndonjë analizë krahasuese ndërmjet dokumentacionit të dorëzuar nga GOE Ankues dhe përfundimeve të tij. Raporti paraqet vetëm konkluzione, **por jo arsyetimin logjik dhe juridik që i lidh provat me këto konkluzione.** Një vendim administrativ nuk mund të mbështetet vetëm në përfundime, por duhet të shpjegojë qartë se si janë vlerësuar provat.

Fakti që vetë Raporti i Vlerësimit të Tenderëve nuk referohet në asnjë dispozitë konkrete ligjore për eliminimin e GOE Ankues dëshmon se vendimi nuk është marrë mbi bazën e ligjit, por mbi vlerësime subjektive dhe supozime. Një qasje e tillë bie ndesh me parimin e ligjshmërisë, transparencës dhe arsyetimit të vendimeve administrative dhe e bën vendimin e Autoritetit Kontraktues juridikisht të paqëndrueshëm.

I. SHKELJET LIGJORE TË AUTORITETIT KONTRAKTUES GJATË PROCEDURËS

Vendimet e Autoritetit Kontraktues, si Vendimi për Rekomandimin e Operatorit Ekonomik fitues ashtu edhe Vendimi për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, janë nxjerrë në kundërshtim flagrant me dispozitat imperative të **Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik**, të ndryshuar dhe plotësuar (LPP), si dhe me **Rregulloren Nr.001/2022 për Prokurimin Publik**, të ndryshuar dhe plotësuar me **Rregulloren Nr.002/2024**, duke cenuar rëndë parimet themelore mbi të cilat ndërtohet sistemi i prokurimit publik në Republikën e Kosovës.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka shkelur, ndër të tjera:

- **nenin 1** të LPP-së, duke mos garantuar përdorimin efikas të fondeve publike, zhvillimin e konkurrencës së drejtë dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë;
- **nenin 7** të LPP-së, duke zbatuar standarde të ndryshme të vlerësimit për operatorë ekonomikë të ndryshëm dhe duke trajtuar Ankuesin në mënyrë diskriminuese;
- **nenin 52** të LPP-së, pasi ekzaminimi dhe vlerësimi i ofertave nuk është bërë në mënyrë objektive, të paanshme dhe në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit;
- **nenin 53** të LPP-së, pasi kontrata është rekomanduar një operatori ekonomik që nuk i plotëson kërkesat për t'u konsideruar operator ekonomik i përgjegjshëm;
- **nenin 59** të LPP-së, pasi Komisioni i Vlerësimit nuk ka kryer ekzaminim dhe vlerësim të plotë,

profesional dhe të dokumentuar të ofertës së Ankuesit;

- **nenin 60** të LPP-së, pasi nuk ka bërë vlerësim korrekt të përgjegjshmërisë së operatorëve ekonomikë;
- **nenin 61** të LPP-së, pasi ka keqinterpretuar dhe keqzbatuar dispozitat mbi ofertat me çmim jonormalisht të ulët, duke mos u bazuar në prova objektive, por në supozime;
- **nenin 72** të LPP-së, pasi nuk ka përdorur në mënyrë të drejtë mekanizmin ligjor të sqarimeve dhe nuk ka analizuar dokumentacionin dhe provat e dorëzuara nga Ankuesi;
- **nenet 65 deri 70** të LPP-së, pasi procedura e përzgjedhjes së operatorit ekonomik nuk është zhvilluar në përputhje me kërkesat ligjore;
- **nenin 81** të LPP-së, pasi çështjet që lidhen me ekzekutimin e ardhshëm të kontratës i ka trajtuar në mënyrë të kundërligjshme gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, ndonëse ligji i rezervon ato për fazën e menaxhimit të kontratës;
- **nenin 108/A** të LPP-së, pasi Kërkesa për Rishqyrtim nuk është shqyrtuar në mënyrë reale, objektive dhe efektive, por është refuzuar me arsyetime të përgjithshme dhe pa analizuar provat dhe pretendimet e Ankuesit.

Këto shkelje nuk përbëjnë vetëm parregullsi procedurale, por **janë shkelje materiale të Ligjit për Prokurimin Publik**, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin e procedurës së prokurimit, duke prodhuar një vendim administrativ të kundërligjshëm, arbitrar dhe diskriminues. Autoriteti Kontraktues, në vend që të zbatonte dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe të bënte një vlerësim objektiv të ofertave, ka vepruar në mënyrë selektive dhe të pabarabartë, konkretisht:

a) ka eliminuar Grupin e Operatorëve Ekonomik **KSF MAJOR SH.A. & MEB L.L.C.**, ndonëse oferta jonë ishte oferta me çmimin më të ulët dhe e përgjegjshme, duke e mbështetur vendimin në supozime dhe jo në prova;

b) nuk ka analizuar në mënyrë reale dhe objektive sqarimet, analizën financiare dhe dokumentacionin e dorëzuar nga Ankuesi, ndonëse ato janë dorëzuar brenda afatit ligjor dhe në përputhje me kërkesën e Autoritetit Kontraktues;

c) nuk ka identifikuar asnjë mangësi konkrete në analizën financiare të Ankuesit dhe nuk ka arsyetuar me fakte apo dispozita ligjore se për cilën arsye ajo analizë nuk është pranuar;

d) **ka shpërfillur deklaratat zyrtare të Ankuesit**, të cilat janë pjesë integrale e ofertës dhe përmes të cilave Ankuesi ka marrë obligim juridik për respektimin e Ligjit të Punës, Vendimit të Qeverisë Nr.10/273 për pagën minimale prej **500.00 € bruto**, pagesën e kontributeve pensionale, legjislacionit tatimor dhe të gjitha dispozitave të tjera ligjore gjatë realizimit të kontratës;

e) ka toleruar mangësi materiale dhe mospërputhje në ofertën e Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë, të cilat, po të zbatoheshin të njëjtat standarde ligjore si ndaj Ankuesit, do të rezultonin me shpalljen e ofertës së tij si të papërgjegjshme;

f) ka aplikuar standarde të ndryshme të vlerësimit ndaj operatorëve ekonomikë, duke interpretuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në mënyrë restriktive ndaj Ankuesit dhe në mënyrë favorizuese ndaj operatorit

ekonomik të rekomanduar;

g) ka zëvendësuar provat, dokumentacionin dhe deklaratimet zyrtare të Ankuesit me vlerësime subjektive dhe supozime lidhur me mënyrën e mundshme të realizimit të kontratës, ndonëse **asnjë dispozitë e LPP-së nuk autorizon Komisionin e Vlerësimit të eliminojë një operator ekonomik mbi bazën e parashikimeve hipotetike për ekzekutimin e ardhshëm të kontratës.**

Është me rëndësi të theksohet se **Komisioni i Vlerësimit nuk ka kompetencë të paragjykojë nëse një operator ekonomik do ta respektojë apo jo kontratën në të ardhmen.** Kompetenca e tij kufizohet ekskluzivisht në verifikimin e përmbushjes së kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar gjatë procedurës së prokurimit. Çdo çështje që lidhet me mënyrën e ekzekutimit të kontratës, respektimin e pagës minimale, të drejtave të punëtorëve apo detyrimeve të tjera ligjore rregullohet nga **neni 81 i LPP-së**, përmes mekanizmave të menaxhimit të kontratës, garancisë së ekzekutimit dhe mjeteve të tjera juridike, e jo përmes eliminimit të operatorit ekonomik në fazën e vlerësimit të ofertave.

Për më tepër, gjatë shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë një shqyrtim efektiv sipas **nenit 108/A të LPP-së**, por është kufizuar në përsëritjen e konkluzioneve të Komisionit të Vlerësimit, pa analizuar pretendimet, provat dhe dokumentacionin e paraqitur nga Ankuesi. Vendimi i datës **17.07.2026** nuk përmban arsyetim individual për secilin pretendim ankimor dhe nuk përmbush standardin minimal të një vendimi administrativ të ligjshëm.

Për pasojë, shkeljet e kryera nga Autoriteti Kontraktues janë të natyrës materiale dhe thelbësore, kanë cenuar integritetin e procedurës së prokurimit, kanë deformuar rezultatin e saj dhe kanë prodhuar një vendim administrativ të kundërligjshëm, arbitrar, diskriminues dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, për çka i njëjti duhet të anulohet në tërësi dhe lënda të kthehet në rivlerësim në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe Rregullores së KRPP-së.

1. Shkelja e Nenit 7 të LPP-së – Trajtimi i Barabartë, Mosdiskriminimi, Proporcionaliteti dhe Transparenca:

Neni 7 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik përbën një nga shtyllat themelore të sistemit të prokurimit publik në Republikën e Kosovës dhe obligon çdo Autoritet Kontraktues që, gjatë gjithë procedurës së prokurimit, të sigurojë **trajtim të barabartë, mosdiskriminim, proporcionalitet dhe transparencë** ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë. Ky parim nuk është deklarativ, por ka karakter **imperativ**, duke e detyruar Autoritetin Kontraktues që të zbatojë të njëjtat kritere juridike, të njëjtën metodologji vlerësimi dhe të njëjtin standard rigorozi ndaj çdo operatori ekonomik që merr pjesë në procedurë.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka devijuar në mënyrë të qartë nga ky obligim ligjor, duke aplikuar **standarde të ndryshme të vlerësimit**, gjë që ka rezultuar në trajtim të pabarabartë dhe diskriminues ndaj Grupit të Operatorëve Ekonomik **KSF MAJOR SH.A. & MEB L.L.C.**

Aplikimi selektiv i Ligjit

Nga dokumentacioni i administruar gjatë procedurës rezulton se ndaj Ankuesit është aplikuar një standard

jashtëzakonisht restriktiv, ndërsa ndaj operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë është aplikuar një standard dukshëm më tolerant. Ndaj Ankuesit, Autoriteti Kontraktues ka ndërtuar vendimin mbi **supozime hipotetike**, duke pretenduar se gjatë realizimit të kontratës mund të mos respektohen detyrimet që burojnë nga **Ligji i Punës, Vendimi i Qeverisë Nr. 10/273 për pagën minimale prej 500.00 € bruto** dhe legjislacioni tjetër në fuqi, ndonëse:

- ka dorëzuar **deklarata zyrtare**, të nënshkruara dhe të vulosura, për respektimin e të gjitha dispozitave ligjore;
- ka marrë obligim kontraktual për respektimin e pagës minimale, kontributeve pensionale dhe të gjitha obligimeve ligjore;
- Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar **asnjë provë konkrete** që dëshmon se oferta jonë është e përealizueshme apo se nuk mbulon këto obligime.

Përkundrazi, ndaj operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë **International Security AAH SH.P.K.**, Autoriteti Kontraktues ka toleruar mangësi materiale dhe nuk ka zbatuar të njëjtin standard ligjor të verifikimit, megjithëse Ankuesi ka ngritur në mënyrë të argumentuar, ndër të tjera, çështje që lidhen me:

a) vlefshmërinë e licencës;

b) mënyrën e kalkulimit të pagës minimale dhe mbulimin real të kostove sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit;

c) dokumentacionin që dëshmon përmbushjen e kërkesave profesionale, ligjore dhe teknike.

Sikur të ishte zbatuar ndaj operatorit ekonomik të rekomanduar i njëjti standard juridik dhe faktik që është zbatuar ndaj Ankuesit, oferta e tij nuk do të mund të konsiderohej ofertë e përgjegjshme sipas dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik.

Mospërfillja e pretendimeve të Ankuesit

Të gjitha këto shkelje janë ngritur me kohë dhe janë argumentuar me prova konkrete në **Kërkesën për Rishqyrtim**, ku Ankuesi ka dëshmuar se Autoriteti Kontraktues ka zbatuar një interpretim selektiv dhe të paqëndrueshëm të Ligjit për Prokurimin Publik. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë **asnjë analizë individuale** të këtyre pretendimeve, nuk është ballafaquar me provat e paraqitura dhe nuk ka dhënë arsyetim juridik për refuzimin e tyre. Përkundrazi, Kërkesa për Rishqyrtim është refuzuar me konstatime të përgjithshme dhe deklarative, duke mos përmbushur standardin e arsyetimit të kërkuar nga **neni 108/A i LPP-së**.

Cenimi i parimit të trajtimit të barabartë

Parimi i trajtimit të barabartë nuk nënkupton vetëm lejimin formal të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurë, por kërkon që Autoriteti Kontraktues të zbatojë **të njëjtat kritere ligjore, të njëjtën metodologji vlerësimi dhe të njëjtin nivel rigoroziteti** ndaj çdo operatori ekonomik. Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në mënyrë diametralisht të kundërt me këtë parim. Ai ka interpretuar

ofertën e Ankuesit në mënyrë tepër restriktive, duke u mbështetur në supozime për ekzekutimin e ardhshëm të kontratës, ndërsa ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar e ka interpretuar në mënyrë favorizuese, duke toleruar mospërputhje që, po të zbatoheshin standardet e njëjta, do të çonin në eliminimin e tij. Një qasje e tillë përbën **trajtim të pabarabartë, diskriminim procedural dhe zbatim selektiv të Ligjit për Prokurimin Publik**, duke cenuar rëndë integritetin e procedurës, konkurrencën e ndershme dhe besimin në sistemin e prokurimit publik.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 7 të LPP-së, duke mos garantuar trajtim të barabartë, proporcional, transparent dhe jodiskriminues ndaj operatorëve ekonomikë. Kjo shkelje nuk është thjesht procedurale, por ka ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin e procedurës së prokurimit, duke sjellë eliminimin e kundërligjshëm të Ankuesit dhe rekomandimin për kontratë të një operatori ekonomik ndaj të cilit nuk janë zbatuar të njëjtat standarde ligjore dhe faktike. Për këtë arsye, vendimi i kontestuar është arbitrar, selektiv, i pambështetur në ligj dhe duhet të anulohet nga OSHP.

2. Shkelja e Nenit 52 të LPP-së – Mosrespektimi i Kritereve të Vlerësimit dhe Dhënies së Kontratës

Autoriteti Kontraktues është i obliguar që gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe rekomandimit për dhënien e kontratës të zbatojë në mënyrë strikte kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik. Këto kritere janë detyruese dhe nuk mund të ndryshohen, interpretohen në mënyrë selektive apo të zëvendësohen me kritere subjektive gjatë fazës së vlerësimit të ofertave. Në Dosjen e Tenderit është përcaktuar shprehimisht se kriter për dhënien e kontratës është "**Çmimi më i lirë**", ndërsa kontrata mund t'i jepet vetëm operatorit ekonomik që paraqet ofertën me çmimin më të ulët dhe njëkohësisht është **operator ekonomik i përgjegjshëm**, në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Është fakt i pakontestueshëm se oferta e Grupit të Operatorëve Ekonomik **KSF MAJOR SH.A. & MEB L.L.C.** ishte oferta me çmimin më të ulët në këtë procedurë.

Po ashtu, gjatë gjithë procedurës Autoriteti Kontraktues nuk ka konstatuar asnjë mungesë administrative, profesionale apo teknike në ofertën tonë. Eliminimi i Ankuesit nuk është bazuar në mospërmbushjen e ndonjë kriteri të Dosjes së Tenderit, por ekskluzivisht në një interpretim subjektiv të ofertës financiare dhe në supozime për mënyrën e mundshme të realizimit të kontratës në të ardhmen.

Në këto rrethana, duke qenë se:

- a) kriteri i dhënies së kontratës ishte "**Çmimi më i lirë**";
- b) oferta e Ankuesit ishte oferta me çmimin më të ulët;
- c) Ankuesi kishte dorëzuar dokumentacion administrativ, profesional, teknik dhe financiar të plotë;
- d) Autoriteti Kontraktues nuk ka provuar me asnjë provë objektive se oferta është ekonomikisht e perealizueshme;

AK nuk kishte asnjë bazë ligjore për ta eliminuar Ankuesin.

Përkundrazi, Autoriteti Kontraktues ka devijuar nga kriteri i shpallur në Dosjen e Tenderit dhe e ka zëvendësuar atë me një kriter të ri, të paparashikuar në dokumentet e tenderit, duke bërë vlerësime subjektive mbi ekzekutimin e ardhshëm të kontratës. **Një veprim i tillë bie ndesh me parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe sigurisë juridike, pasi kriteret e tenderit nuk mund të ndryshohen apo zgjerohen pas hapjes së ofertave.** Për më tepër, Ankuesi ka argumentuar edhe në Kërkesën për Rishqyrtim, me prova dhe dokumentacion konkret, se operatori ekonomik **International Security AAH SH.P.K.** nuk i përmbush kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit dhe nuk mund të konsiderohet operator ekonomik i përgjegjshëm. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk i ka shqyrtuar këto pretendime në mënyrë objektive dhe, në kundërshtim me LPP-në, ka rekomanduar për kontratë një ofertë që nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e LPP-së që rregullojnë ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertave, duke cenuar ligjshmërinë e procedurës dhe duke bërë të kundërligjshëm rekomandimin për dhënien e kontratës.

3. Shkelja e Nenit 53 të LPP-së – Moskonstatimi i Ofertës së Përgjegjshme

Neni 53 i LPP-së obligon Autoritetin Kontraktues që, para dhënies së kontratës, të konstatojë në mënyrë objektive nëse operatori ekonomik i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe nëse oferta e tij është ofertë e përgjegjshme. Ky vlerësim duhet të mbështetet ekskluzivisht në dokumentacionin e dorëzuar gjatë procedurës dhe jo në supozime, paragjykime apo vlerësime hipotetike.

Në rastin konkret, GOE Ankues ka dorëzuar:

- a) dokumentacionin administrativ të plotë;
- b) dëshmitë për përmbushjen e kriterëve profesionale;
- c) dokumentacionin teknik sipas Dosjes së Tenderit;
- d) ofertën financiare të përgatitur sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit;
- e) të gjitha dokumentet tjera të kërkuara;
- f) sqarimet plotësuese të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues brenda afatit ligjor.

Në asnjë fazë të procedurës Autoriteti Kontraktues nuk ka konstatuar se Ankuesi nuk i plotëson kriteret e përshtatshmërisë apo se dokumentacioni i tij është i paplotë. Eliminimi është mbështetur ekskluzivisht në një interpretim subjektiv të ofertës financiare dhe jo në mospërmbushjen e ndonjë kriteri të Dosjes së Tenderit.

Nga ana tjetër, Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë të njëjtin verifikim rigoroz ndaj operatorit ekonomik **International Security AAH SH.P.K.**, ndonëse Ankuesi ka dëshmuar me prova konkrete në Kërkesën për Rishqyrtim ekzistencën e mospërputhjeve materiale me kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit. Mosveprimi

i Autoritetit Kontraktues për të verifikuar në mënyrë të njëjtë përgjegjshmërinë e të gjithë operatorëve ekonomikë përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 53 të LPP-së dhe cenon parimin e trajtimit të barabartë.

4. Shkelja e Nenit 59 të LPP-së – Mungesa e Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Analizës Objektive të Ofertës së Ankuesit

Neni 59 i LPP-së obligon Autoritetin Kontraktues që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave ta zhvillojë në mënyrë profesionale, objektive dhe të bazuar vetëm në dokumentacionin e administruar gjatë procedurës. Ky nen, në lidhje me **nenin 72 dhe nenin 61 të LPP-së**, obligon Autoritetin Kontraktues që sqarimet e kërkuara nga operatori ekonomik jo vetëm t'i pranojë, por edhe t'i analizojë në mënyrë reale, të arsyetuar dhe të dokumentuar.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar Ankuesit sqarim lidhur me pershkrimin e cmimit. Në respektim të plotë të kësaj kërkesë dhe brenda afatit ligjor, Ankuesi ka dorëzuar::

- a) strukturën financiare të ofertës;
- b) metodologjinë e kalkulimit të cmimit;
- c) deklaratimet zyrtare për respektimin e pagës minimale prej 500.00 € bruto;
- d) deklaratimet për pagesën e kontributeve pensionale dhe për respektimin e të gjitha dispozitave të Ligjit të Punës dhe legjislacionit në fuqi.

Pavarësisht kësaj, nga Raporti i Vlerësimit dhe Vendimi për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim rezultojnë se Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë asnjë analizë konkrete dhe të individualizuar të dokumentacionit të dorëzuar. Vendimet nuk identifikojnë se cili element i analizës financiare është konsideruar i pasaktë, cili dokument nuk është pranuar, cilat llogaritje janë vlerësuar si të pamjaftueshme apo për çfarë arsye sqarimet nuk janë konsideruar bindëse.

Në mungesë të një analize të tillë, Autoriteti Kontraktues nuk ka vendosur mbi bazën e provave, por mbi konkluzione të përgjithshme dhe supozime, duke e bërë vendimin arbitrar, të paarsyetuar dhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së

5. Shkelja e Nenit 60 Të LPP-së – Mos Shpërmblymi me Kontratë GOE të Përgjegjshëm:

Një nga shkeljet më të rënda materiale të kryera nga Autoriteti Kontraktues konsiston në moszbatimin e drejtë të **nenit 60 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik**, i cili obligon Autoritetin Kontraktues që kontratën publike t'ia japë **operatorit ekonomik të përgjegjshëm**, i cili:

- a) i plotëson të gjitha kërkesat administrative, profesionale, teknike dhe financiare të përcaktuara në Dosjen e Tenderit;

b) ka paraqitur ofertë të përgjegjshme në kuptim të LPP-së;

c) është vlerësuar sipas kriterit të dhënies së kontratës të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Në procedurën konkrete, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar shprehimisht se kriter për dhënien e kontratës është "**Çmimi më i lirë**". Ky kriter është detyrues dhe nuk i jep Autoritetit Kontraktues kompetencë që gjatë fazës së vlerësimit të krijojë kriteret e reja, të ndryshojë kriteret e shpallura apo të eliminojë operatorin ekonomik mbi bazën e supozimeve lidhur me ekzekutimin e ardhshëm të kontratës.

Është fakt i pakontestueshëm se **GOE KSF MAJOR SH.A. & MEB L.L.C.**:

- ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin administrativ, profesional, teknik dhe financiar të kërkuar;
- ka plotësuar të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit;
- ka paraqitur ofertën me çmimin më të ulët;
- ka dorëzuar, brenda afatit ligjor, edhe sqarimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Në asnjë fazë të procedurës Autoriteti Kontraktues nuk ka konstatuar se Ankuesi nuk i plotëson kriteret e përshtatshmërisë ose se oferta përmban mangësi administrative, profesionale apo teknike. Për rrjedhojë, nuk ka ekzistuar asnjë bazë ligjore që oferta jonë të mos konsiderohej **ofertë e përgjegjshme** në kuptim të nenit 60 të LPP-së. Pavarësisht kësaj, Autoriteti Kontraktues ka eliminuar Ankuesin jo për shkak të ndonjë mospërbushjeje të kërkesave të Dosjes së Tenderit, por mbi bazën e një vlerësimi hipotetik për mënyrën e mundshme të realizimit të kontratës në të ardhmen, duke tejkaluar kompetencat që i njeh Ligji për Prokurimin Publik.

Autoriteti Kontraktues nuk ka analizuar sqarimet dhe provat e dorëzuara nga Ankuesi

Nga dokumentacioni administrativ rezulton se GOE Ankues, në përputhje me kërkesën e Autoritetit Kontraktues dhe brenda afatit ligjor, ka dorëzuar:

a) strukturën reale të kostove;

b) metodologjinë e kalkulimit të ofertës;

c) deklarimin zyrtar për respektimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 10/273 dhe pagës minimale prej **500.00 € bruto**;

d) deklarimin për pagesën e kontributeve pensionale dhe detyrimeve të tjera ligjore;

e) deklarimin zyrtar për respektimin e Ligjit të Punës, legjislacionit në fuqi dhe të gjitha obligimeve kontraktore. Për më tepër, këto deklarata nuk janë dorëzuar vetëm si sqarime, por kanë qenë pjesë integrale e ofertës sonë dhe përbëjnë obligime juridike dhe kontraktuale për Ankuesin.

Megjithatë, nga Raporti i Vlerësimit dhe Vendimi për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim nuk rezulton se Autoriteti Kontraktues ka analizuar ndonjë prej këtyre dokumenteve.

Vendimi nuk identifikon:

- cilat llogaritje financiare konsiderohen të pasakta;
- cilat elemente të analizës financiare janë refuzuar;
- cilat deklarime janë konsideruar të pabesueshme;
- mbi cilat prova konkrete mbështetet përfundimi i tij.

Në mungesë të një analize të tillë, Autoriteti Kontraktues nuk ka përmbushur detyrimet që burojnë nga **nenet 59, 61 dhe 72 të LPP-së**, pasi nuk ka bërë një vlerësim real, objektiv dhe të dokumentuar të sqarimeve të dorëzuara.

Autoriteti Kontraktues ka zëvendësuar ofertën e Ankuesit me një kalkulim hipotetik të ndërtuar prej vetë tij

Nga arsyetimi i vendimit rezulton se Autoriteti Kontraktues nuk ka analizuar ofertën financiare të paraqitur nga Ankuesi, por ka ndërtuar një kalkulim teorik të bazuar në supozime, duke përdorur elemente si:

- 21 punëtorë;
- paga minimale prej 500.00 €;
- periudha 24-mujore;
- TVSH-ja.

Ky nuk është analizim i ofertës së dorëzuar.

Ky është një model financiar hipotetik, i ndërtuar nga vetë Autoriteti Kontraktues. Ligji për Prokurimin Publik nuk autorizon Autoritetin Kontraktues që të zëvendësojë ofertën financiare të operatorit ekonomik me një model financiar të krijuar nga vetë ai. Detyrimi ligjor është që të vlerësohet oferta e dorëzuar dhe dokumentacioni shoqërues, e jo të krijohen skenarë hipotetikë që nuk burojnë nga oferta.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues nuk ka zhvilluar procedurën e analizës së kërkuar nga neni 61 i LPP-së, por ka ndërtuar një arsyetim abstrakt dhe të pambështetur në prova.

Eliminimi i Ankuesit është mbështetur mbi supozime dhe jo mbi prova

Vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk përmban asnjë provë konkrete që dëshmon se GOE Ankues nuk do të respektojë:

a) pagën minimale prej 500.00 € bruto;

b) pagesën e kontributeve pensionale;

c) Ligjin e Punës;

d) obligimet kontraktore;

e) legjislacionin në fuqi.

Përkundrazi, në ofertë dhe në dokumentacionin plotësues Ankuesi ka deklaruar në mënyrë të qartë, të pakushtëzuar dhe juridikisht detyruese se të gjitha këto obligime do të respektohen gjatë realizimit të kontratës. Autoriteti Kontraktues nuk ka administruar asnjë provë që rrëzon këto deklarime.

Ekziston një dallim thelbësor juridik ndërmjet **provës** dhe **supozimit**. Ligji kërkon prova konkrete dhe të verifikueshme. Ligji nuk lejon që një operator ekonomik të eliminohet mbi bazën e hipotezave, dyshimeve apo parashikimeve për sjelljen e tij të ardhshme. **Në mungesë të provave, vendimi mbetet një vlerësim subjektiv dhe hipotetik, i cili nuk mund të prodhojë pasoja juridike.**

Autoriteti Kontraktues ka ngatërruar fazën e vlerësimit me fazën e ekzekutimit të kontratës

Një tjetër shkelje serioze juridike konsiston në faktin se Autoriteti Kontraktues ka bërë parashikime për mënyrën se si Ankuesi mund ta realizojë kontratën në të ardhmen.

Një qasje e tillë është në kundërshtim me sistemin e LPP-së, i cili bën dallim të qartë ndërmjet:

a) fazës së ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave; dhe

b) fazës së menaxhimit dhe ekzekutimit të kontratës.

Çështje si respektimi i pagës minimale, pagesa e kontributeve, respektimi i Ligjit të Punës apo detyrimeve të tjera kontraktore kontrollohen gjatë **ekzekutimit të kontratës**, përmes mekanizmave të parashikuar në **nenin 81 të LPP-së**, garancisë së ekzekutimit, mbikëqyrjes së kontratës, penaliteteve kontraktuale, ndërprerjes së kontratës dhe mjeteve të tjera ligjore. Prandaj, Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur asnjë bazë ligjore që, në fazën e vlerësimit të ofertave, të paragjykojë sjelljen e ardhshme të Ankuesit dhe, mbi atë bazë, ta eliminojë ofertën e tij.

Një veprim i tillë bie në kundërshtim me **nenet 7, 59, 60, 61, 72 dhe 81 të LPP-së**, cenon parimin e proporcionalitetit dhe tejkalon kompetencat ligjore të Komisionit të Vlerësimit.

Për më tepër, operatori ekonomik i rekomanduar për dhënien e kontratës nuk mund të konsiderohet operator ekonomik i përgjegjshëm në kuptim të LPP-së, pasi Ankuesi ka dëshmuar me prova konkrete, si në Kërkesën për Rishqyrtim ashtu edhe në këtë ankesë, se oferta e tij përmban mospërputhje materiale me kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit

2. Autoriteti Kontraktues ka Vepruar në Kundërshtim me Nenet 59, 60 dhe 65–70 të LPP-së gjatë Vlerësimit të Ofertës së Operatorit Ekonomik të Shpallur Fitues:

Edhe nëse Paneli Shqyrtues, vetëm për hir të argumentimit (*argumentum ad abundantiam*), nuk do të pranonte pretendimet e GOE Ankues lidhur me eliminimin e kundërligjshëm të ofertës sonë, vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk mund të mbetet në fuqi për një arsye tjetër thelbësore dhe të pavarur juridikisht. Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për dhënien e kontratës operatorin ekonomik **International Security AAH SH.P.K.**, ndonëse nga dokumentacioni i administruar në procedurë dhe nga provat e paraqitura nga Ankuesi në Kërkesën për Rishqyrtim rezultojnë mospërputhje materiale me kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit, të cilat pengojnë që ai operator ekonomik të konsiderohet **operator ekonomik i përgjegjshëm**, në kuptim të neneve **59, 60 dhe 65–70 të LPP-së**. Sipas Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues nuk ka detyrim vetëm të identifikojë ofertën me çmimin më të ulët, por paraprakisht ka obligim ligjor të verifikojë në mënyrë të plotë, objektive dhe të dokumentuar se operatori ekonomik:

- a) i plotëson të gjitha kriteret administrative;
- b) i plotëson kriteret profesionale;
- c) i plotëson kriteret teknike;
- d) i plotëson kriteret financiare;
- e) posedon dokumentacion të vlefshëm gjatë gjithë fazës së vlerësimit;
- f) përmbush pa përjashtim të gjitha kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit.

Ky detyrim është **imperativ** dhe nuk i lë Autoritetit Kontraktues asnjë diskrecion për të toleruar mangësi materiale ose për të interpretuar në mënyrë selektive kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Licenca e operatorit ekonomik të rekomanduar nuk plotëson kushtin ligjor në momentin e vlerësimit

Nga dokumentacioni i administruar në këtë procedurë rezulton se licenca e operatorit ekonomik të rekomanduar nuk përmbushte kushtin e vlefshmërisë në momentin kur Komisioni i Vlerësimit ka kryer ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertave. Ky nuk është një lëshim formal apo i natyrës administrative, por prek një nga kushtet themelore të përgjegjshmërisë profesionale të operatorit ekonomik. Posedimi i një licence të vlefshme nuk është një dokument që mund të zëvendësohet, të plotësohet ose të tolerohet pas hapjes së ofertave, por është kusht ligjor për ushtrimin e aktivitetit dhe për pjesëmarrjen e ligjshme në procedurën e prokurimit publik. Nëse operatori ekonomik nuk dëshmon se posedon autorizimin e kërkuar dhe të vlefshëm në momentin kur bëhet vlerësimi i ofertave, ai nuk mund të konsiderohet operator ekonomik i përgjegjshëm sipas LPP-së.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues nuk kishte bazë ligjore dhe as kompetencë diskrecionale për ta rekomanduar atë për dhënien e kontratës.

Mosverifikimi i kësaj kërkesë përbën shkelje të drejtpërdrejtë të neneve **59, 60 dhe 65–70 të LPP-së**.

Autoriteti Kontraktues ka aplikuar standarde të dyfishta gjatë vlerësimit të ofertave

Një nga shkeljet më të rënda të evidentuara në këtë procedurë është aplikimi i standardeve të ndryshme juridike dhe faktike ndaj operatorëve ekonomikë, në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

Ndaj GOE Ankues, Autoriteti Kontraktues ka zbatuar standardin më rigoroz të mundshëm, duke eliminuar ofertën tonë mbi bazën e supozimeve për ekzekutimin e ardhshëm të kontratës, megjithëse:

- nuk ka identifikuar asnjë mangësi administrative, profesionale apo teknike;
- nuk ka kundërshtuar me argumente dokumentacionin financiar;
- nuk ka vërtetuar se deklaratimet tona zyrtare nuk janë të besueshme;
- nuk ka administruar asnjë provë që oferta jonë është ekonomikisht e përzueshme.

Ndërkohë, ndaj operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në mënyrë krejtësisht të kundërt. Mangësitë materiale janë toleruar, dokumentacioni është interpretuar në favor të tij, ndërsa pretendimet dhe provat e paraqitura nga Ankuesi në Kërkesën për Rishqyrtim nuk janë trajtuar në mënyrë objektive dhe nuk janë kundërshtuar me arsyetim juridik. Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktues ka zbatuar **dy standarde të ndryshme vlerësimi** brenda së njëjtës procedurë të prokurimit: një standard jashtëzakonisht rigoroz ndaj Ankuesit dhe një standard dukshëm më tolerant ndaj operatorit ekonomik të rekomanduar.

Një praktikë e tillë cenon rëndë parimet e **barazisë në trajtim, mosdiskriminimit, proporcionalitetit dhe transparencës**, deformon konkurrencën e ndershme dhe bie ndesh me qëllimin e Ligjit për Prokurimin Publik.

Parimi i trajtimit të barabartë nuk nënkupton vetëm të drejtën për të marrë pjesë në procedurë, por obligon Autoritetin Kontraktues që të zbatojë të njëjtin standard juridik, të njëjtin standard provues dhe të njëjtin nivel rigoziteti ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë. Në rastin konkret, ky standard është shkelur në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar, duke bërë që rekomandimi për dhënien e kontratës operatorit ekonomik International Security AAH SH.P.K. të jetë i kundërligjshëm dhe, si i tillë, të mos mund të mbetet në fuqi.

OPERATORI EKONOMIK I SHPALLUR FITUES NUK KA RESPEKTUAR KËRKESËN E DOSJES SË TENDERIT PËR PAGËN MINIMALE:

Një tjetër fakt material, i cili dëshmon se oferta e operatorit ekonomik International Security AAH SH.P.K. nuk mund të konsiderohet ofertë e përgjegjshme në kuptim të neneve 59 dhe 60 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, lidhet me mënyrën e kalkulimit të pagës minimale dhe me trajtimin selektiv që Autoriteti Kontraktues ka zbatuar gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave.

Autoriteti Kontraktues ka eliminuar GOE Ankues me arsyetimin se oferta jonë kinse nuk garanton mbulimin e pagës minimale prej 500.00 € bruto, duke pretenduar se oferta nuk siguron respektimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 10/273, ndonëse në ofertën tonë dhe në dokumentacionin e dorëzuar janë përfshirë deklaratat zyrtare, të nënshkruara dhe të vëlosura, me të cilat GOE Ankues është zotuar shprehimisht se gjatë realizimit të kontratës do të respektojë pagën minimale prej 500.00 € bruto, Ligjin e Punës, pagesën e kontributeve pensionale dhe të gjitha detyrimet tjera ligjore. Këto deklaratat janë pjesë integrale e ofertës sonë dhe përbëjnë obligime juridike dhe kontraktuale, të cilat Autoriteti Kontraktues ishte i detyruar t'i merrte në konsideratë gjatë vlerësimit të ofertës.

Në të njëjtën kohë, gjatë procedurës së sqarimeve të zhvilluar nga vetë Autoriteti Kontraktues, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, International Security AAH SH.P.K., në sqarimet e dorëzuara prej tij ka deklaruar se oferta financiare është kalkuluar duke përdorur pagën minimale prej **425.00 € për një pjesë të periudhës kontraktore, ndërsa vetëm për periudhën pasuese është përdorur paga minimale prej 500.00 €**. Pra, ky fakt nuk është pretendim i GOE Ankues, por rezulton nga vetë deklaratimet e operatorit ekonomik të rekomanduar, të dorëzuara në kuadër të procedurës së sqarimeve dhe të administruara nga Autoriteti Kontraktues.

Përkundër këtij fakti, Autoriteti Kontraktues nuk e ka konsideruar këtë mospërputhje si arsye për ta shpallur ofertën e operatorit ekonomik International Security AAH SH.P.K. të papërgjegjshme, por e ka rekomanduar atë për dhënie të kontratës.

Ky veprim është thellësisht kontradiktor dhe arbitrar.

Nga njëra anë, Autoriteti Kontraktues ka eliminuar GOE Ankues duke pretenduar se oferta jonë nuk garanton respektimin e pagës minimale prej 500.00 € bruto, megjithëse ne kemi dorëzuar deklarata zyrtare që garantojnë respektimin e saj gjatë realizimit të kontratës. Nga ana tjetër, i njëjti Autoritet Kontraktues ka pranuar dhe ka rekomanduar për kontratë një operator ekonomik i cili vetë ka deklaruar, në sqarimet e dorëzuara, se oferta e tij është ndërtuar duke përdorur pagën prej 425.00 € për një pjesë të periudhës kontraktore dhe ne FDT kusht ka qene te jet paga 500 euro bruto. Nëse, sipas qëndrimit të Autoritetit Kontraktues, respektimi i pagës minimale prej 500.00 € bruto përbën kusht thelbësor për përgjegjshmërinë e ofertës, atëherë i njëjti standard juridik dhe faktik është dashur të zbatohet edhe ndaj operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të eliminojë një operator ekonomik vetëm mbi bazën e një supozimi se në të ardhmen mund të mos respektojë pagën minimale, ndërkohë që toleron dhe pranon një ofertë ku vetë operatori ekonomik ka deklaruar se kalkulimi i ofertës është bërë mbi bazën e pagës minimale prej 425.00 € për një pjesë të periudhës kontraktore, **në kundërshtim me kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit**. Një veprim i tillë përbën zbatim selektiv të Ligjit për Prokurimin Publik, cenon rëndë parimin e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit, transparencës dhe ligjshmërisë të përcaktuar në nenin 7 të LPP-së, si dhe përbën shkelje të drejtpërdrejtë të neneve 59 dhe 60 të LPP-së, pasi Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar të njëjtin standard të verifikimit dhe vlerësimit ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë. Në procedurën konkrete, AK ka zbatuar standarde të ndryshme të provës. Ndaj GOE Ankues ka kërkuar dhe ka interpretuar dokumentacionin në mënyrë shumë rigorozë, ndërsa ndaj operatorit të rekomanduar ka toleruar mangësi dhe deklarime pa të njëjtin nivel verifikimi. Një qasje e tillë cenon drejtpërdrejt parimin e trajtimit të barabartë të garantuar me nenin 7 të LPP-së.

SHKELJA E PARIMIT TË KONSISTENCËS GJATË VLERËSIMIT:

Një autoritet kontraktues nuk mund të zbatojë dy standarde të ndryshme në të njëjtën procedurë.

Në rastin konkret ndodh pikërisht kjo.

Për Ankuesin:

- a) çdo dyshim interpretohet në mënyrën më të pafavorshme;
- b) çdo pasiguri përdoret si bazë eliminimi;
- c) çdo supozim konsiderohet provë.

Ndërsa për operatorin fitues:

- a) mangësitë konsiderohen të parëndësishme;
- b) mospërputhjet tolerohen;
- c) deklaratimet pranohen pa të njëjtin nivel verifikimi.

Ky trajtim selektiv nuk përbën ushtrim të ligjshëm të diskrecionit administrativ. Ai përbën diskriminim

procedural. Prandaj vendimi është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

AUTORITETI KONTRAKTUES NUK KA DHËNË PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMEVE TË KËRKESËS PËR RISHQYRTIM:

Një ndër mangësitë më serioze të vendimit të datës 17.07.2026 është fakti se Autoriteti Kontraktues nuk ka shqyrtuar realisht pretendimet e paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim të GOE Ankues, të cilat I kemi ngritur, ndër të tjera:

- a) dëshmia e pa kontestueshme e licencës së skaduar të operatorit fitues;
- b) dëshmia e pa kontestueshme e mospërputhjes së kalkulimit të pagave sipas kërkesave në dosje të tenderit;
- c) dëshmi të pa kontestueshme të cilat vërtetojnë se AK ka vepruar në kundërshtim me LPP-në për trajtim të pabarabartë gjatë vlerësimit të ofertave;
- d) pretendimin për shkeljen e nenit 61;

Megjithatë, vendimi i AK-së nuk përmban një analizë të veçantë për secilin prej këtyre pretendimeve. Ai nuk shpjegon:

- a) pse licenca e cila është e skaduar është konsideruar e vlefshme;
- b) pse kalkulimi i pagave konsiderohet në përputhje me Dosjen e Tenderit edhe pse OE I rekomanduar për kontratë ka prekur formatin e tabelës së përshkrimit të çmimit;
- c) pse standardi i aplikuar ndaj operatorit fitues ndryshon nga ai i aplikuar ndaj GOE Ankues;
- d) pse janë refuzuar argumentet juridike të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim.

Një vendim administrativ që nuk i përgjigjet pretendimeve thelbësore të palës nuk përmbush standardin e arsyetimit të kërkuar nga drejta administrative dhe cenon të drejtën për mbrojtje juridike efektive.

3. Shkelja e Nenit 108/A Të Ligjit për Prokurimin Publik:

Neni 108/A i LPP-së nuk e obligon Autoritetin Kontraktues vetëm të nxjerrë një vendim formal mbi kërkesën për rishqyrtim.

Ligji e obligon AK që të zhvillojë një rishqyrtim real, efektiv dhe të argumentuar të pretendimeve të operatorit ekonomik. Ky detyrim nënkupton:

- a) analizimin individual të çdo pretendimi;
- b) administrimin e provave të paraqitura;
- c) arsyetimin juridik dhe faktik të vendimit;
- d) shpjegimin e bazës ligjore mbi të cilën refuzohet secili pretendim.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk e ka përmbushur këtë standard.

Qëllimi i kësaj dispozite është që Autoriteti Kontraktues të korrigjojë çdo shkelje eventuale të ligjit para se çështja të dërgohet në Organin Shqyrtues të Prokurimit, duke garantuar një mjet administrativ efektiv dhe një procedurë të drejtë.

Ky detyrim ligjor nënkupton që Autoriteti Kontraktues duhet:

- a) të analizojë në mënyrë individuale dhe të veçantë secilin pretendim të ngritur në Kërkesën për Rishqyrtim;
- b) të administrojë dhe të vlerësojë të gjitha provat dhe dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik;
- c) të japë arsyetim të plotë juridik dhe faktik për secilin pretendim;
- d) të identifikojë dispozitat konkrete ligjore mbi të cilat mbështetet refuzimi i secilit pretendim;
- e) të argumentojë pse provat e paraqitura nga Ankuesi nuk janë pranuar ose nuk konsiderohen të mjaftueshme;
- f) të zhvillojë një rivlerësim real të ligjshmërisë së vendimit fillestar dhe jo vetëm ta konfirmojë atë në

mënyrë automatike.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk e ka përmbushur asnjërin nga këto standarde.

Vendimi i datës 17.07.2026 nuk përmban analizë juridike dhe faktike për pretendimet thelbësore të ngritura nga GOE Ankues, por kufizohet në përsëritjen e konstatimeve të Komisionit të Vlerësimit, pa u ballafaquar me provat dhe argumentet e paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim.

Në veçanti, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë përgjigje të arsyetuar lidhur me:

provat e paraqitura për vlefshmërinë e licencës së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë; provat që dëshmojnë se vetë operatori ekonomik i rekomanduar, gjatë procedurës së sqarimeve, ka deklaruar se oferta e tij është kalkuluar mbi pagën minimale prej 425.00 € për një pjesë të periudhës kontraktore, ndonëse GOE Ankues është eliminuar me arsyetimin se kinse nuk garanton pagën minimale prej 500.00 € bruto;

argumentet dhe provat që dëshmojnë aplikimin e standardeve të dyfishta gjatë vlerësimit të ofertave; pretendimet për zbatimin e gabuar të nenit 61 të LPP-së dhe për mungesën e analizës objektive të ofertës së GOE Ankues;

argumentet juridike lidhur me shkeljen e neneve 7, 59, 60 dhe 72 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues nuk ka analizuar asnjë nga këto pretendime në mënyrë individuale dhe nuk ka dhënë arsyetim juridik se përse i konsideron të pabazuara. Vendimi përmban vetëm konstatime të përgjithshme dhe deklarative, pa analizë të provave, pa arsyetim të individualizuar dhe pa ballafaqim me faktet e paraqitura nga Ankuesi.

Një vendim administrativ që nuk u përgjigjet pretendimeve thelbësore të palës, nuk analizon provat e administruara dhe nuk arsyeton refuzimin e tyre, nuk përmbush standardin minimal të arsyetimit të kërkuar nga neni 108/A i LPP-së, cenon të drejtën e operatorit ekonomik për mbrojtje juridike efektive dhe e bën procedurën e rishqyrtimit një formalitet të zbrazët. Për pasojë, procedura e rishqyrtimit ka humbur funksionin e saj ligjor si mjet administrativ efektiv për korrigjimin e shkeljeve të mundshme të Ligjit për Prokurimin Publik dhe është reduktuar në një konfirmim formal dhe automatik të vendimit fillestar, pa një rivlerësim real të ligjshmërisë së tij.

Një qasje e tillë bie ndesh me qëllimin e nenit 108/A të LPP-së, cenon parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe administrimit të mirë, si dhe i mohon GOE Ankues të drejtën për një shqyrtim administrativ efektiv.

KONKLUZIONET JURIDIKE

Nga të gjitha provat e administruara në këtë procedurë, nga dokumentacioni i tenderit, nga sqarimet e operatorëve ekonomikë, nga Kërkesa për Rishqyrtim, nga Vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzimin e saj, si dhe nga dispozitat imperative të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, rezulton pa asnjë dyshim se vendimi i kontestuar është i kundërligjshëm, është nxjerrë mbi një vlerësim të gabuar të fakteve dhe të ligjit dhe, si i tillë, nuk mund të prodhojë pasoja juridike.

Gjatë zhvillimit të kësaj procedure, Autoriteti Kontraktues ka cenuar rëndë parimet themelore mbi të cilat mbështetet sistemi i prokurimit publik në Republikën e Kosovës, duke shkelur dispozitat imperative të **neneve 1, 7, 59, 60, 61, 69, 72, 81 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik.**

Nga analiza e dokumentacionit rezulton se Autoriteti Kontraktues nuk ka zhvilluar një proces objektiv, të paanshëm dhe të ligjshëm të ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave, por ka zbatuar standarde të ndryshme

juridike ndaj operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në të njëjtën procedurë.

Ndaj GOE Ankues është aplikuar një standard jashtëzakonisht rigoroz dhe i pabazuar në ligj, duke u eliminuar oferta mbi bazën e supozimeve se gjatë fazës së ekzekutimit të kontratës kinse nuk do të respektohej paga minimale prej 500.00 € bruto, ndonëse GOE Ankues kishte dorëzuar deklarata zyrtare, të nënshkruara dhe të vulosura, me të cilat ishte zotuar për respektimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 10/273, Ligjit të Punës dhe të gjitha detyrimeve ligjore e kontraktore. Në anën tjetër, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, gjatë procedurës së sqarimeve, ka deklaruar vetë se oferta e tij financiare është kalkuluar duke përdorur pagën minimale prej 425.00 € për një pjesë të periudhës kontraktore, megjithatë kjo rrethanë nuk është konsideruar pengesë për shpalljen e tij fitues.

Prandaj, Autoriteti Kontraktues ka zbatuar **dy standarde të ndryshme juridike** brenda së njëjtës procedurë të prokurimit, duke eliminuar GOE Ankues mbi bazën e një supozimi, ndërsa duke toleruar tek operatori ekonomik i rekomanduar një rrethanë që lidhet drejtpërdrejt me të njëjtin element mbi të cilin është bazuar eliminimi i Ankuesit. Një veprim i tillë përbën shkelje të rëndë të parimit të trajtimit të barabartë, proporcionalitetit, transparencës, ligjshmërisë dhe konkurrencës së ndershme, të garantuara me nenin 7 të LPP-së. Po ashtu, Autoriteti Kontraktues **nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë procedurën e paraparë me nenin 61 të LPP-së për vlerësimin e ofertave me çmim jonormalisht të ulët.** Edhe pse ka kërkuar sqarime

nga GOE Ankues dhe ato janë dorëzuar brenda afatit ligjor, së bashku me analizën financiare, deklaratat zyrtare dhe dokumentacionin mbështetës, vendimi nuk përmban asnjë analizë konkrete, objektive apo profesionale të këtyre provave.

Përkundrazi, Autoriteti Kontraktues ka zëvendësuar analizën e provave me supozime dhe vlerësime teorike, pa administruar asnjë ekspertizë financiare, kontabël apo profesionale që do të provonte se oferta e GOE Ankues nuk ishte ekonomikisht e realizueshme. Ligji nuk autorizon eliminimin e një operatori ekonomik vetëm për shkak se oferta e tij është më e ulët ai kërkon që një vendim i tillë të mbështetet në prova objektive, të verifikueshme dhe të arsyetuara, të cilat në këtë rast mungojnë tërësisht. Gjithashtu, **Autoriteti Kontraktues ka tejkaluar kompetencat e tij duke paragjykuar fazën e ekzekutimit të kontratës, ndonëse kontrolli i respektimit të pagës minimale, i Ligjit të Punës dhe i obligimeve kontraktore zhvillohet vetëm gjatë fazës së menaxhimit të kontratës, sipas nenit 81 të LPP-së, dhe jo gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.**

Për më tepër, vendimi mbi Kërkesën për Rishqyrtim nuk përmbush standardin e kërkuar nga neni 108/A i LPP-së, pasi Autoriteti Kontraktues nuk ka analizuar individualisht pretendimet e GOE Ankues, nuk ka administruar dhe vlerësuar provat e paraqitura, nuk ka dhënë arsyetim juridik dhe faktik për refuzimin e secilit pretendim dhe nuk ka zhvilluar një rivlerësim real të ligjshmërisë së vendimit fillestar. Në këtë mënyrë, procedura e rishqyrtimit është reduktuar në një formalitet administrativ dhe jo në një mjet efektiv për korrigjimin e shkeljeve të ligjit.

VENDIMI PËR RISHQYRTIM NUK PËRMBUSH STANDARDIN E NJË VENDIMI ADMINISTRATIV TË ARSYETUAR:

Përveç shkeljeve materiale të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik, edhe vetë **Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 17.07.2026** është juridikisht i cenueshëm, pasi nuk përmbush standardet minimale ligjore që duhet të përmbajë një vendim administrativ i arsyetuar. Në përputhje me **nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik**, si dhe me parimet themelore të **Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative**, Autoriteti Kontraktues kishte detyrimin që, gjatë shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim, të zhvillonte një proces real, objektiv dhe të argumentuar, duke vërtetuar gjendjen faktike dhe duke arsyetuar në mënyrë të plotë vendimin e tij. Mungesa e përgjigjes ndaj pretendimeve thelbësore e bën të pamundur kontrollin efektiv të ligjshmërisë së vendimit. Nëse AK nuk shpjegon pse i refuzon provat dhe argumentet e

Ankuesit, pala nuk ka mundësi të kuptojë bazën reale të vendimit dhe as Paneli Shqyrtues nuk mund të verifikojë nëse diskrecioni administrativ është ushtruar në mënyrë të ligjshme..

Një vendim administrativ i ligjshëm duhet të përmbajë së paku:

- a) analizën individuale të secilit pretendim të paraqitur nga pala;
- b) administrimin dhe vlerësimin e secilës provë të dorëzuar;
- c) arsyetimin faktik dhe juridik për secilin konstatim të bërë;
- d) shpjegimin e dispozitave ligjore të zbatuara dhe mënyrën se si ato janë aplikuar në rastin konkret;
- e) një lidhje logjike ndërmjet provave të administruara, gjendjes faktike të konstatuar dhe përfundimit juridik të nxjerrë.

Vendimi i kundërshtuar nuk përmbush asnjërin nga këto standarde.

Ai:

- **nuk trajton individualisht** pretendimet e ngritura nga GOE Ankues;
- **nuk analizon dhe nuk vlerëson** provat e dorëzuara gjatë procedurës së rishqyrtimit;
- **nuk jep asnjë arsyetim juridik** për refuzimin e analizës financiare dhe dokumentacionit mbështetës të paraqitur nga GOE Ankues;
- **nuk shpjegon** përse deklaratat e nënshkruara dhe të vulosura të GOE Ankues, me të cilat garantohet respektimi i pagës minimale prej **500.00 € bruto** dhe i të gjitha obligimeve ligjore, janë injoruar gjatë vlerësimit;
- **nuk jep përgjigje** lidhur me pretendimin se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, në sqarimet e tij, ka deklaruar se oferta është kalkuluar mbi bazën e pagës minimale prej **425.00 €** për një pjesë të periudhës kontraktore;
- **nuk arsyeton** përse licenca e operatorit ekonomik të rekomanduar, për të cilën Ankuesi ka ngritur pretendime konkrete, është konsideruar e rregullt dhe e pranueshme;
- **nuk jep asnjë arsyetim** lidhur me pretendimet për shkeljen e neneve **7, 59, 60, 61, 69, 72 dhe 81 të Ligjit për Prokurimin Publik.**

Në vend të një analize juridike dhe faktike, Autoriteti Kontraktues është kufizuar në **përsëritjen e konkluzioneve të Komisionit të Vlerësimit**, pa bërë një rivlerësim të pavarur të pretendimeve dhe provave të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim. Një vendim administrativ që nuk analizon provat, nuk u përgjigjet pretendimeve konkrete të palës dhe nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm juridik **nuk përmbush standardin e një akti administrativ të ligjshëm**, cenon të drejtën e operatorit ekonomik për një mjet juridik efektiv dhe bie ndesh me kërkesat e **nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik** dhe me parimet themelore të **Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative**, të cilat kërkojnë që çdo vendim administrativ të jetë i bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, në prova objektive dhe në një arsyetim

të plotë juridik. Për rrjedhojë, procedura e rishqyrtimit nuk ka përmbushur funksionin e saj ligjor si mjet administrativ efektiv për korrigjimin e shkeljeve të mundshme të Ligjit për Prokurimin Publik, por është reduktuar në një **konfirmim formal dhe automatik të vendimit fillestar**, pa një rivlerësim real të ligjshmërisë së tij.

Për këto arsye, Paneli Shqyrtues i OSHP-së duhet të konstatojë se vendimi i Autoritetit Kontraktues është marrë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, ta anulojë atë dhe të urdhërojë rivlerësimin e procedurës në përputhje me ligjin, duke garantuar respektimin e parimeve të ligjshmërisë, transparencës, proporcionalitetit, konkurrencës së ndershme dhe trajtimit të barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë.

Andaj duke u bazuar në dëshmitë e paraqitura në këtë Ankersë, kriteret e dosje së tenderit, dhe dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar; faktet e provuara gjatë procedurës së prokurimit; dokumentacionin e administruar në dosjen e tenderit dhe argumentet juridike të paraqitura në këtë ankesë, i propozohet panelit shqyrtues të Organit Shqyrtues të Prokurimit që pas administrimit të provave të nxjerrë VENDIMIN, përmes të cilit:

- I. **Ta aprovojë** në tërësi këtë ankesë si të bazuar.
- II. **Ta anulojë** Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 17.07.2026, me të cilin është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik KSF MAJOR SH.A. & MEB L.L.C.
- III. **Ta anulojë** Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 08.07.2026 (Formulari B58) për dhënien e kontratës Operatorit Ekonomik International Security AAH SH.P.K.;
- IV. **Të konstatojë** se eliminimi i Grupit të Operatorëve Ekonomik KSF MAJOR SH.A. & MEB L.L.C. është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik.
- V. **Të konstatojë** se Autoriteti Kontraktues nuk ka zhvilluar procedurën e shqyrtimit të ofertës me çmim jonormalisht të ulët në përputhje me nenin 61 të LPP-së, pasi nuk ka bërë analizë objektive dhe të arsyetuar të sqarimeve të dorëzuara nga Ankuesi.
- VI. **Të konstatojë** se Autoriteti Kontraktues ka cenuar parimin e trajtimit të barabartë duke aplikuar standarde të ndryshme të vlerësimit ndaj operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurë.
- VII. **Ta urdhërojë** Autoritetin Kontraktues që të bëjë rivlerësimin e plotë të të gjitha ofertave, duke zbatuar në mënyrë të njëjtë dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe kërkesat e Dosjes së Tenderit për të gjithë operatorët ekonomikë.

Me respekt,